





This programme is funded
by the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



NEW REALITY OF THE HERITAGE SITES



MUZEU HISTORIK I QYTETIT BAJRAM CURRI

Eshtë ngritur në vitin 1985 me financimin e drejtimin e Ministrisë, së -Kulturës,dhe udhëheqjen metodike e shkencore nga (Sektori i muze .ve) pranë Ministrisë së Kulturës dhe Muzeut Historik Kombëtar Ndërtim i projektuar nga arkitekt Maksim Mitrojorgji, hapja dhe .përurimi i të cilit u bë më 11 Janar 1988


Eshtë një ndër muzetë më të bukur përsa i përket arkitekturës së jashtme dhe të brendshme, e cila paraqet një stilizim të kullës tradicionale të malësisë së veriut, ku modernja është kombinuar shumë bukur me traditën duke krijuar një ansambël të vërtete historiko-arkitekturor dhe një hijeshi të lakmueshme edhe për vizitorët. Mjediset e këtij muzeu janë të bollshme dhe më se funksionale. Sallat përbërëse të tij janë projektuar dhe realizuar në formën e rrathëve koncentrik dhe me një ndarje të kateve në formë të tillë që kalon nga njëri kat në tjetrin pa u vënë re me 3-4 shkallë

It was established in 1985 with funding and management from the Ministry of Culture, and methodological and scientific guidance from the Museum Sector of the Ministry of Culture and the National .Historical Museum


The building was designed by architect Maksim Mitrojorgji, and its .opening and inauguration took place on January 11, 1988

It is one of the most beautiful museums in terms of both exterior and interior architecture, which presents a stylized version of the traditional tower of the northern mountains. Modernity has been beautifully combined with tradition, creating a true historical-architectural ensemble and an admirable elegance for visitors

The spaces of this museum are spacious and highly functional. The component halls are designed and realized in the form of concentric circles, and the division of the floors is such that one moves from one .floor to another seamlessly with 3-4 steps



1. Hyrja e qytetit
Bajram Curri
- 2.Pozicioni gjeografik
ne harten me distance
1 km nga hyrja e qytetit





- 1 Bazorelievi me tematike historike në faqen e jashtme të muzeut i punuar me Bronx. ndertuar nga skulptori Isa Baliaj. / A bas-relief with a historical theme on the exterior facade of the museum, crafted in bronze.
- 2 Mozaik,me tematikë nga qendresa antiosmane e shek. XVI-XVII-të, realizuar nga piktori Agim Nebiu./Mosaic depicting the anti-Ottoman resistance of the 16th–17th centuries, created by painter Agim Nebiu.
- 3 Pikturë murale (afresk),me tematikë: Organizimi fisnor vetëqeverisës i Malësisë së Gjakovës, realizim i piktorit Nazmi Hoxha./Mural painting (fresco) illustrating the tribal self-governance of Malësia e Gjakovës, executed by painter Nazmi Hoxha.
- 4 Pikturë murale (afresk),me tematikë: "Malësia e Gjakovës dhe Kosova në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe shpalljen e pavarësisë kombëtare, 1912". Realizim i piktorit Nexhat Majollari./Mural painting (fresco) themed "Malësia e Gjakovës dhe Kosova in the Albanian League of Prizren and the Declaration of National Independence, 1912," created by painter Nexhat Majollari.
- 5 Pikturë murale (afresk),me tematike: "Pjesmarrja e Malësisë në luftën antifashiste nacionalçlirimtare", realizim i piktorit Abdulla Gjongeci./Mural painting (fresco) depicting "The Participation of Malësia in the National Liberation Anti-Fascist War," executed by painter Abdulla Gjongeci.
- 6 Dy kolona betoni tëgdhendura mbi të cilat janë skalitur emrat e dëshmorëve të rënë për Atdhe nga viti 1900 – 1939./Two engraved concrete columns bearing the names of the martyrs who sacrificed for the homeland from 1900–1939.
- 7 Maket me allçi i Hartës gjeologjike të Tropojës /Plaster model of the Geological Map of Tropojë.
- 8 Këndi i një sobe burrash apo (oda e miqve) Kthinë e rëndësishme banimi, funksioni kryesor i të cilës mbetet pritja e mikut, i cili i shoqëruar nga i zoti i shtëpise, aty ushqehet, fle dhe kalon kohën e lirë. /The Corner of a Men’s Room (Guest Room)A significant living space, primarily used for hosting guests. The guest, accompanied by the head of the house, would eat, sleep, and spend leisure time there.
- 9 Oxhaku- Vend qendror pranë njërit prej mureve të kthinës sëbanimit, që ka pjesën e hapur nëmur (lugun), daljen mbi çatit (tymarin) dhe vatrën (poshtë në nivelin e dyshemese), ku ndizet zjarri për ngrohje a për gatim. /A central spot near one of the room’s walls, featuring an open section in the wall (the chimney flue), an outlet on the roof (the smoke vent), and a hearth (at floor level) where a fire was lit for heating or cooking
- 10 Sofër e vjetër: Tryeze dërrase shumë e ulët, në trajtë të rumbullakët e me mbështetëse të larta dy pëllëmbë (rreth 30-40cm), rreth të cilës ulen njerëzit për ngrënie. Bëhej me dërrasë pishe, bredhi apo molike./Old Low Wooden Table (Sofër)A round, very low wooden table with tall edges (about 30–40 cm high), around which people would sit for meals. It was made from pine, fir, or molika wood.
- 11 Tangari- Mbajtëse prej hekuri për prush për tu ngrohur.Ka formë të rrumbullakët dhe mbahet në tre kembë .Ofrohej dhe në odat e miqve. /Tangari (Iron Ember Holder) A round, three-legged iron stand used to hold embers for warming. It was also placed in guest rooms.
- 12 Vegsha prej balte që përdorehin si ene guzhine për gjellëra të ndryshme.Prodhoheshin në Gjakovë dhe nga fshatarët mirditorë. /Clay Pots (Vegsha)Used as kitchenware for various dishes. They were produced in Gjakovë and by Mirdita villagers.
- 13 Koritë :bëhej prej druri pishe,ahu apo frashëri dhe ka formë katërkëndore.Përdorej për të hedhur qumështin e valuar,i cili duhet të qëndrojë 12-24 orë që më pas ti merret maza (ajka). /Milk Trough (Korita) Made from pine, beech, or ash wood and rectangular in shape. It was used to hold boiled milk, which had to sit for 12–24 hours before the cream (ajka) was collected.
- 14 Fund buke: bëhej prej dërrase pishe në formë të rrumbullakët me trashësi rreth 1cm.Madhësia e tyre bëhej sa madhësia e çerepit në të cilin piqeshin bukët.Magjatorja (ajo që gatuan bukë)përdorte dy funda buke,për ta punuar dhe ngjeshur brumin para se të hidhej në çerep për tu pjekur. /Bread Board (Fund Buke) A round wooden board, about 1 cm thick, made of pine. Its size matched that of the clay baking dome (çerep) used for baking bread. The baker (magjatorja) used two such boards to knead and prepare the dough before placing it under the dome for baking.
- 15 Saçë për pjekje - Ishte një furrë e thjeshtë, primitive, me material hekuri në formë të rrumbullakët e ngritur gati në formë këmbane dhe me dorezë sipër, e cila pasi nxeht mirë mbi zjarr, mbulohet me hi dhe me prush dhe shërbente për të pjekur ushqime të ndryshme në tepsi. /Traditional Baking Dome (Saçë)A simple, primitive iron oven shaped like a dome with a handle on top. Once heated over fire, it was covered with ash and embers, allowing various foods to be baked in a tray beneath it.s collected.
- 16 Vekë –Vegël pune që gratë e përdorin për të thurur veshje të ndryshme, shoka për ti vendosur në brez,pësjtjellak grash,zaprega, shtrroja të ndryshme(shilte ,qilima sixhade), rroba fjetjeje(plafa ,dysheke) etj.Si material përdorej leshti i bagëtiëve të imëta (deleve). /Loom (Veki)A weaving tool used by women to make clothing, belts, aprons, blankets, rugs, and bedding such as woolen covers and mattresses. The material used was sheep’s wool, which was first spun into yarn
- 17 Dueq - Formë trastash për tu hedhur në shalë të kalit,por edhe për përdorime të tjera.Kur ato beheshin per nusët prodhoheshin në vekme lesh delesh të imtëta me ngjyrat dhe modelet me te mira. /Saddle Bags (Dueq or Hebet) Double-sided woven bags designed to be placed over a horse’s saddle, but also used for various daily needs. When made for brides, they were crafted from fine sheep’s wool with decorative patterns
- 18 Djepi-Djepi i një fëmije nga zona e Bytyçit i shpuar nga 13 plumba prej nazistëve gjermanë në verën e vitit 1944. /The Cradle – A child’s cradle from the Bytyç area, pierced by 13 bullets fired by German Nazis in the summer of 1944
- 19 Havani- Havan i vjetër që e përdornin burrat për të grirë duhan. /Mortar (Havan) – An old mortar used by men for grinding tobacco.
- 20 Stelë varri (182 cm x 61 cm x 25 cm, prej graniti) heklis pas krishtit Në stelë është emri i të varrosurit Mark Ulpi 11 vjeç. Stela është punuar nga i ati Prisk Ulpi. Në krye të stelës shkruhet latinisht: "Ne duart e perendise se shenjeje". Këtu ndodhet i drejti Mark Ulpi. /Gravestone Stele (182 cm x 61 cm x 25 cm, made of granite) – 1st-2nd century AD. The stele bears the name of the deceased, Mark Ulpi, an 11-year-old boy, crafted by his father, Prisk Ulpi. At the top of the stele, a Latin inscription reads: "In the hands of the Holy God. Here rests the righteous Mark Ulpi."
- 21 Veshja me Xhubletë: Xhubleta veshja me e vjetër që e ka të qëndisur historinë e popullit shqiptar. /Xhubleta: The Oldest Albanian Dress – The xhubleta, an ancient Albanian women’s garment, is embroidered with symbols representing the history of the Albanian people
- 22 Xhubletë grash e zonës Nikaj –Mertur. Karakteristikë brezi si dhe opangët me lekurë lope. /Women’s Xhubleta from Nikaj-Mértur – Distinctive for its belt and leather opinga (traditional shoes).
- 23 Xhublete vajzash e zonës Nikaj-Mertur. /Girls’ Xhubleta from Nikaj-Mértur.
- 24 Veshje burrash me tirqe e zonës Nikaj-Mertur.Karakteristikë dhe opangët me lëkurë kau /Men’s Traditional Attire from Nikaj-Mértur – Featuring woolen trousers (tirqe) and leather opinga made from cowhide.
- 25 Veshje nusesh me pshtjellak të gjerë (origjinal) e zonës -Gash-Krasniqe. /Bridal Attire from the Gash-Krasniqe Region – Featuring a wide pësjtjellak (traditional wrap skirt), original.
- 26 Veshje grash e zonës së Bytyçit -me merhame (origjinale). /Women’s Traditional Clothing from Bytyç – Including merhame (a traditional headdress, original).
- 27 Veshje nusesh me pësjtjellak(origjinal vetëm pshtjellaku) e zonës -Gash-Krasniqe. /Bridal Attire from Gash-Krasniqe – Featuring an original pësjtjellak (wrap skirt).
- 28 Veshje e ngushtë e grave e zonës-Gash -Krasniqe. /Fitted Women’s Attire from Gash-Krasniqe.
- 29 Veshje burrash e zones Gash -Krasniqe (imitim). /Men’s Traditional Clothing from Gash-Krasniqe – A replica